

## AKTI I THEMELIMIT

### I shoqerise tregtare me pergjegjesi të kufizuar: “ SUNSET Management ” Sh.p.k.

#### NENI 1

Ne Sarande sot me 08.02.2024 shtetasit e poshteshenuar, me vullnet te lire dhe te plote krijone shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar:

“ SUNSET Management ” Sh.p.k.

#### NENI 2

Selia Qendrore e shoqerise: “ SUNSET Management ” Sh.p.k. do te jete ne adresën:  
Vlore, Sarande, Lagjja nr.4, Rruga Idriz Alidhima, Ap. me nr. pasurie 22/154+1-36, vol. 47,  
faqe 149, zk.8641. 2

#### NENI 3

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte pa afat te percaktuar, duke filluar afati nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.  
Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Q.K.B. per të bere shenimet e nevojshme.

#### NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare: “ SUNSET Management ” Sh.p.k. do te jete:  
Sherbim Pastrimi dhe menaxhimi i apartamenteve.

#### NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke (njqindmije) lek, formuar dhe nenshkruar nga 2 ortak ose 2 kuota.

- Ortaku themelues: MARCIN PIOTROWSKI Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 67,000 (gjashtedhjetë e shtatë mijë) Lek që përben 67 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues: RUSLANA POHREBNOVA Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë

të përgjithshme 33,000 (tridhjetë e tre mijë) Lek që përben 33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaket kane pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### NENI 6

Kapitali Themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr Asambleja e Ortakëve, i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës. Në këto raste, vendimi merret nga ortaket që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit themeltar.

#### NENI 7

Ortaket duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos të demtojnë interesat e personave të tjerë të shoqërisë.

#### NENI 8

Shoqëria cel llogari bankare në lekë dhe në cdo lloj valute të huaja, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

#### NENI 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1-Asambleja e Ortakëve

2-Administratori

Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe Administratorit do të përcaktohen në statutin e shoqërisë tregtare “**SUNSET Management**” Sh.p.k.

#### NENI 10

Shoqëria do të drejtohet nga 1 Administrator për një afat 5 vjeçar:

Administratori do të jetë:

Znj. RUSLANA POHREBNOVA

#### NENI 11

Çdo mosmarrveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, në të

kunderten kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Shkalles së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

**NENI 12**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, veçanërisht me ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" (të ndryshuar).

**NENI 13**

Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

**NENI 14**

Akti i Themelimit përmban 3 faqe, u përpilua në 2 kopje dhe u nënshkrua rregullisht nga ortaket themelues.

**Themeluesit e shoqërisë**

MARCIN PIOTROWSKI



RUSLANA POHREBNOVA

